

**KOMISIONET PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET
BASHKËSIVE**

Vendosja, mandati dhe përvojat ekzistuese

er

Botues: Shoqata „Instituti për Zhvillim të Bashkësive“ – Tetovë
Adresa: Lubo Bozhinovski – Pish 82, Tetovë, Maqedoni
Telefon: +389-44-340-677; +389-70-250-286
E-mail: cdi@mt.net.mk Internet faqja: www.mic.org.mk
Për botuesin: Sreten Koceski

Redaktor: Sreten Koceski

Bashkëpunëtorë: Dimçe Josifovski, Natasha Jakovçevska,
Pranvera Kasami, Violeta Josifovska

Falënderim të veçantë për: Aleksandra Bojaxhieva

Përkthimi në gjuhën shqipe: Burim Emini

Redaktimi Gjuhësor: Ilir Ajdini

Përpunimi grafik: Mirçe Novakovski

Shtyp: Hartija Komerc – Tetovë

Programi Bona Mente – forcimi i kapaciteteve të komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive është financiarisht i mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni vëzhgues në Shkup.

Përmbajtja e këtij botimi nuk do të thotë që çdoherë i reflekton pikëpamjet ose qëndrimet e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka „Sv. Kliment Ohridski“,
Skopje
352.075.2:323.1 (497.7) (035)
KOMISII za odnosi megju zaednicite / Sreten Koceski . – Tetovo :
Zdruzenie Institut za razvoj na zaednicata, 2007. – 21 str. ; 24 cm
Fusnoti kon tekstot. – Bibliografija: str. 23
ISBN 978-9989-2626-1-6
1. Sreten Koceski
a) Komisii za odnosi megju zaednicite – Opstini – Makedonija
Priracnici:
COBISS.MK – ID 68115210

Komisionet për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive - KMNB

Vendosja, mandati dhe përvojat ekzistuese

PARATHËNIE – PËR PROJEKTIN	4
KOPJE NGA KY DORRACAK MUNDET TË GJENDET NË ZYRAT E IZHB, NDËRSA VERZIONIN ELEKTRONIK MUND TA GJENI NË WWW.MIC.ORG.MK.....	4
HYRJE	5
1) KOMISIONI PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE (KMNB).....	5
2) VENDOSJA DEMOKRATIKE.....	6
II FORMIMI DHE PUNA E KMNB	8
1) LIGJI PËR VETËQEVERISJE LOKALE.....	8
2) STATUTI I KOMUNËS.....	9
3) RREGULLORJA	14
4) MBËSHËTETJA NGA ANA E KOMUNËS.....	15
III MANDATI I KOMISIONIT	16
1) ÇËSHTJET JURIDIKO-OBLIGUESE.....	17
2) ZGJIDH KONFLIKTET DHE MOSMARRËVESHJET – RASTET TË CILAT DO TË MUND TË SHQYRTOHEN NGA KOMISIONI	21
3) PROMOVIMI I MARRËDHËNIEVE TË MIRA MES BASHKËSIVE – DREJTIME TË MUNDSHME PËR AKTIVITETET E KMNB.....	25
SHTOJCË	27
4) LISTA E KOMUNAVE TË CILAT KANË OBLIGIM TË FORMOJNË KMNB	27
5) PROPOZIM PËR PËRMBAJTJEN E RREGULLORES PËR PUNË TË KMNB	28
IV REFERENCAT/BIBLIOGRAFIA.....	31

Parathënie – Për projektin

“Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive/Vendosja, mandati dhe përvojat ekzistuese”, është botim i përgatitur në suaza të projektit Bona Mente ("Mendim i Mirë"). Qëllimi i projektit është forcimi i kapaciteteve të KMNB në komunat të cilat kanë obligim ligjor për formimin e tyre. Ky botim u dedikohet anëtarëve të tashëm dhe të ardhshëm të komisioneve, këshilltarëve dhe administratës komunale si dhe të gjithë qytetarëve të interesuar. Përmbajtja e përshkruan mënyrën e formimit, mandatin dhe obligimet ligjore të komisionit, si dhe drejtimet dhe rekomandimet për punën e komisioneve. Përmbajtja është përgatitur mbi bazë të hulumtimeve të funksionimit të komisioneve të kryera gjatë vitit 2006, mbi analizat e rregullativës ligjore vendore dhe ndërkombëtare, mendimet e ekspertëve dhe intervistat dhe bisedat në fokus-grupe të anëtarëve të KMNB të cilat marrin pjesë në trajnimin nga IZHB.

Projekti financiarisht dhe teknikisht është i mbështetur nga Komisioni Vëzhgues i OSBE-së. Aktivitetet e OSBE-së në fushën e analizës dhe mbështetjes të KMNB filloi me kërkesë të Bashkësisë të Njësive Vetëqeverisëse Lokale (BNJVL) me kërkesë të së cilës, në fillim të 2006 pas një sërë konsultimesh, u organizua një konferencë e përfaqësuesve komunalë të KMNB për shpjegimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe rolit të KMNB. Nga kjo u përpilua dhe u shpërnda deri te komunat modeli i statutit i cili e rregullon punën e KMNB.

Kopje nga ky dorracak mundet të gjendet në zyrat e IZHB, ndërsa verzionin elektronik mund ta gjeni në www.mic.org.mk

HYRJE

1) Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)

Procesi i decentralizimit dhe sistemi i vetëqeverisjes lokale, si një nga themelet kyçe për paqën dhe stabilitetin e shtetit, i dhanë rol edhe më specifik forumeve institucionale për dialog ndëretnik. Gjegjësisht, një nga qëllimet kryesore në zhvillimin e pushtetit të decentralizuar është *afrimi i pushtetit te qytetarët dhe* sigurimi i forumit në të cilin qytetarët lokalë mund t'i mbrojnë dhe t'i zhvillojnë interesat e tyre lokale, duke kontribuar për paqem dhe zhvillimin harmonik të shoqërisë, në të njëjtën kohë duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve. Vetëqeverisja e zhvilluar lokale, po ashtu, krijon kushte të favorshme për *dialog të hapur social, demokraci konsensuale dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve*. E gjithë kjo është ngushtë e lidhur me mundësitë të cilat i ofron një vetëqeverisje e zhvilluar lokale për zhvillimin ekonomik të vetë komunave, por edhe të shtetit në përgjithësi.

Në kontekstin e dhënë, shteti ka traditë më të gjatë në krijimin dhe vendosjen e formave institucionale të dialogut ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, të definuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale nga viti 2002, janë të krijuara për involvimin e bashkësive të ndryshme etnike në procesin e qeverisjes dhe që të njëjtëve t'u jepen mundësi të barabarta për debatim të vendimeve të përbashkëta të pranueshme për çështje të cilat ju përkasin, gjegjësisht i përkasin identitetit të tyre, pa dallim se a janë ato bashkësi të përfaqësuara në këshill apo jo. Kështu, këto komisione luajnë rolin e dyfishtë në kontekstin socio-ekonomik. 1. mundësojnë dialog institucional ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike; dhe 2. paraqiten si instrument për mundësimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes të cilën e udhëheqin përfaqësuesit e zgjedhur.

2) Vendosja demokratike

Sjellja e vendimeve në sisteme demokratike bazohet në pjesëmarrjen e qytetarëve përmes sistemit të quajtur “demokraci përfaqësuese”. Qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre (anëtarë në Kuvendin shtetëror, ndërsa në nivel lokal Këshillin e Komunës), dhe me këto zgjedhje e përcjellin fuqinë e vendosjes mbi këta përfaqësues të zgjedhur. Nderkaq, Këshilli ka obligim që në mënyrën sa më të mirë t'i përfaqësojë interesat e qytetarëve. Duke marrë këtë parasysh, një nga obligimet më të rëndësishme të këshilltarëve është që të vendosin komunikim të rregullt me qytetarët për t'i kuptuar nevojat e tyre dhe në të njëjtën kohë t'i informojnë për planet dhe aktivitetet të cilat i ndërmerr komuna.

Sistemi proporcional zgjedhor nuk garanton se bashkësitë e ndryshme të cilat janë të përfaqësuara në komunë do të jenë të përfaqësuara në mënyrë përkatëse në përbërjen e këshillit komunal. Zakonisht, vërejtjet e shumta kanë të bëjnë me atë se në çdo vendbanim në komunë ka përfaqësues të “vetin” në këshill. Sërish këshilltarët e përfaqësojnë gjithë komunën pa marrë parasysh se në cilin vendbanim jetojnë ose se cilës bashkësi i takojnë. Kryetari i Komunës është i zgjedhur nga ana e të gjithë qytetarëve të komunës dhe duhet t'i përfaqësojë interesat e të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Gjatë vendosjes, këshilltarët, kryetari i komunës dhe administrata komunale duhet mbajtur llogari se përskaaj grupeve etnike në shoqëri ekzistojnë edhe lloje të tjera të bashkësive të cilat dallohen sipas gjinisë, moshës ose tjetër gjë. Të gjitha këto grupe kanë interesa dhe nevoja specifike – për shembull: gratë, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit ose njerëz me nevoja të posaçme. Me rëndësi është që vendimmarrësit të mundësojnë mënyrë apo mekanizma për ta dëgjuar mendimin dhe nevojat e këtyre bashkësive të ndryshme.

E zakonshme është që individët dhe bashkësitë e ndryshme të kenë perceptime dhe prioritete të ndryshme si rezultat i

besimeve dhe bindjeve të tyre individuale apo grupe, kulturore, religjioze dhe të traditave. Me qëllim që të sigurojë mundësi që të prezentohen mendimet dhe qëndrimet e tyre, Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh mekanizma plotësuese. Prandaj vendimmarrësit duhet të kenë parasysh se si politika dhe vendimet e caktuara ndikojnë mbi marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme. Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive – KMNB, vendoset si forum ku bashkësitë e ndryshme (grupet etnike) do të mund të prezentojnë mendimin e tyre për çështje të cilat janë me rëndësi për bashkësinë e tyre.

Koncepti i KMNB bazohet në postulatit: „Mos i fyejmë ndjenjat e të tjerëve“.

II Formimi dhe puna e KMNB

Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB) janë të rregulluara me Ligjin për vetëqeverisje lokale nga viti 2002. Neni 55 nga Ligji parasheh obligim që: “Në komunën në të cilën më së paku 20% e numrit të përgjithshëm të popullatës së komunës të përcaktuar nga regjistrimi i fundit i popullatës janë përfaqësues të bashkësisë së caktuar formohet Komision për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.”

1) Ligji për vetëqeverisje lokale

Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh:

1. Obligimin e komunave të krijojnë KMNB
2. Kompetencat e komisionit:
 - a. të shqyrtojë çështjet të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të përfaqësuara në komunë;
 - b. jep mendim; dhe
 - c. propozime për mënyrën për zgjidhjen e tyre;
3. Obligimet për Kuvendin Komunal
 - a. të shqyrtojë mendimet dhe propozimet nga komisioni;
 - b. të sjellë vendim lidhur me mendimin dhe propozimin e komisionit;

Neni	55
Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive	
(1) Në komunën në të cilën më së paku 20% nga numri i përgjithshëm i popullatës së komunës së caktuar në regjistrimin e fundit të popullatës janë përfaqësues të një bashkësie të caktuar, formohet Komision për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.	
(2) Komisionet nga alineja (1) të këtij neni e përbëjnë numrin e barabartë të përfaqësuesve nga secila bashkësi e	

përfaqësuar në komunë.
(3) Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit rregullohet me statut.
(4) Komisioni i shqyrton çështjet të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të përfaqësuara në komunë dhe japin mendim dhe propozim për mënyrën e zgjidhjes së tyre.
(5) Këshilli i Komunës është i detyruar të shqyrtojë mendimet dhe propozimet nga alineja (4) të këtij neni dhe të vendos në lidhje me të njëjtat.

Përskaj komunave të cilat kanë obligim ligjor dhe çdo komunë e cila mendon se ka nevojë të përmirësojë dialogun ndërmjet bashkësive të cilat jetojnë në territorin e saj mundet të formojë KMNB. Me formimin e këtij Komisioni, komuna mundëson forum përmes të cilit do të mund të dëgjojë mendimin e bashkësive më të vogla të cilat nuk janë në mënyrë adekuate të përfaqësuara në këshillin e komunës dhe të vendosë dialog ndërmjet bashkësive.

Këshilli i Komunës është i obliguar të shqyrtojë mendimet dhe propozimet e KMNB dhe të sjellë vendim lidhur me njëjtat.

2) Statuti i komunës

Detalet rreth formimit dhe punës së Komisionit janë të rregulluara me Statutin e Komunës i cili përcakton:

- cilat bashkësi prezente në Komunë do të jenë të përfaqësuara në komision;
- procedura për zgjedhjen e përfaqësuesve nga secila bashkësi si anëtarë të KMNB;
- anëtarë të komisionit:
 - o numrin e anëtarëve;
 - o numrin e përfaqësuesve (anëtarëve) nga secila bashkësi;

Bashkësitë

Përcaktimi i bashkësive të cilat duhet të jenë të përfaqësuara në Komision, paraqet sfidë, duke marrë parasysh se në secilën komunë ekzistojnë bashkësi të cilat janë të përfaqësuara me një numër të vogël. Për shembull, sipas regjistrimit të fundit të popullatës nga viti 2002 në Dibër janë të regjistruar vetëm dy anëtarë të bashkësisë vllehe. Statuti i komunës duhet të përcaktojë cilat bashkësi do të jenë të përfaqësuara në komision duke marrë parasysh rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë dhe pronës. Këshilli duhet të vendosë se cilat bashkësi janë të përfaqësuara në numër të konsiderueshëm në Komunë. Shpallja në thirrje publike mundet të ndihmojë që të pengohet lëshimi i ndonjë bashkësie relevante.

Kushtetuta i numëron këto bashkësi, si vijon: maqedonas, shqiptarë, turq, vlllehë, romë, serbë dhe boshnjakë; këto janë grupet të cilat janë të përfaqësuara në numër më të madh në nivel kombëtar.

Ekzistojnë edhe grupe etnike të cilat nuk kanë pjesëmarrje të caktuar në komunë dhe janë të regjistruara si “të tjerë”, në të vërtetë, egjiptianët, kroatët dhe të tjerë. Shembull; KMNB në Kërçovë ka përfaqësues të egjiptjanëve, sepse ky grup etnik është i përfshirë në numër të konsiderueshëm në Komunë.

Përfaqësuesit

Zgjedhja e përfaqësuesve adekuatë të bashkësive, paraqet një sfidë shtesë. Përfaqësuesit e zgjedhur duhet të jenë qytetarë të respektuar dhe me ndikim në bashkësitë e tyre. Për dallim nga komisionet tjera të Këshillit të Komunës është e mundur (dhe rekomandohet) që së paku disa nga anëtarët e KMNB të jenë të jashtëm, e jo anëtarë të këshillit.

Ekzistojnë disa mundësi dhe metoda për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit:

- **Nominim nga Komisioni Komunal për zgjedhje dhe emërime** pas konsultimit paraprak me palët relevante të interesuara (partitë politike dhe shoqatat e regjistruara dhe OJQ-të e bashkësive të cilat jetojnë në territorin e Komunës);
- **Konkurs publik** për paraqitjen e kandidatëve;
- **Tubim i qytetarëve** i përfaqësuesve të bashkësisë përkatëse;
- **Propozim i Kryetarit** të Komunës i cili vërtetohet me votim të këshilltarëve;
- **Anketë** për marjen e mendimeve të përfaqësuesve të bashkësive.

Përparësitë dhe mangësitë e metodave të theksuara:

Përshkrim	Përparësitë	Mangësitë
Nominim nga komisioni komunal për zgjedhje dhe emërime pas konsultimi paraprak me palët relevante të interesuara (partitë politike dhe shoqatat e regjistruara dhe OJQ-të e bashkësive të cilat jetojnë në territorin e komunës);	<ul style="list-style-type: none"> - nevojitet më pak kohë; - këshilltarët propozojnë anëtarë të cilët kanë besim dhe me të cilët mund të bashkëpunojnë 	<ul style="list-style-type: none"> -kandidatët mundet të ndjehen politikisht të lidhur; -çdo parti politike propozon kandidatë nga anëtarësia e vet ose simpatizues; -numër i kufizuar i kandidatëve -bashkësitë mundet të kenë ndjenjë të përfaqësuesve të imponuar

<p>Tubim i qytetarëve i qytetarëve nga bashkësia përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Thirje publike; Procedurë e njëjtë e cila përdoret për zgjedhjen e anëtarëve të bashësive lokale 	<ul style="list-style-type: none"> - procedurë e qartë; - transparencë, - objektivitet, 	<ul style="list-style-type: none"> -mundësi për manipulime – me tubim të bashkëmendimtarëv e dhe shokëve; -në rast të interesimit të dobët të bashkësive -logjistikë – të sigurohet hapësirë adekuate; -probleme të mundshme për të siguruar rendin dhe qetësinë
<p>Konkurs publik për paraqitjen e kandidatëve;</p>	<ul style="list-style-type: none"> - mundësi e barabartë – çdo qytetar i interesuar mund të paraqitet - procedurë transparente - mundësi që kandidatët vërtetë të interesuar të paraqiten - kritere publike transparente; - procedurë objektive 	<ul style="list-style-type: none"> -të pranohen propozime të tepërta; -varësisht nga niveli i vetëdijes i bashkësive dhe qasja e tyre proaktive; -procedura të ndërlikuara

Propozim i kryetarit të komunës i cili vërtetohet me votim të këshilltarëve;	- procedurë e thjeshtë	- subjektivitet
Anketë për marrjen e mendimeve të përfaqësuesve të bashkësive	- qasje e strukturuar; - rezultatet lehtë interpretohen; - transparente dhe objektive	- procedurë e ndërlikuar për t'u identifikuar popullata e targetuar në komunë; - mundësia për mungesë të ndonjë anëtari; - shpenzimet financiare

Rezultate nga hulumtimi i OSBE-së dhe IZHB për punën e KMNB1 lidhur me formimin dhe zgjedhjen e anëtarëve

- Nga gjithsejt 21 komuna të anketuara vetëm 5 kanë deklaruar se është shpallur thirrja publike për zgjedhjen e anëtarëve të KMNB.

Në të shumtën e rasteve zgjedhja e anëtarëve të KMNB është kryer nga ana e Këshillit Komunal, ndërsa qytetarët nuk kanë qenë të informuar për ekzistimin e Komisionit. Anëtarët e Komisionit në numrin më të madh të rasteve kanë qenë të propozuar nga ana e këshilltarëve dhe nga Komisioni për zgjedhje dhe emërim. Në 4 Komuna, OJQ-të dhe grupet e qytetarëve kanë propozuar anëtarë të Komisionit të cilët nuk kanë qenë këshilltarë.

Numri i anëtarëve të KMNB dhe numri i përfaqësuesve të secilës bashkësi

Ligji parasheh se çdo bashkësi duhet të jetë e përfshirë në mënyrë të barabartë në KMNB pa dallim pjesëmarrjeje në numrin e përgjithshëm të popullatës në komunë, me qëllim që të mundësohet e drejta për votë të barabartë për të gjitha bashkësitë.

SHEMBULL: numër i barabartë, do të thotë se çdo bashkësi do të ketë nga një ose dy ose tre ose më shumë përfaqësues në komision.

Gjatë vendosjes së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KMNB duhet të mbahet llogari që të jenë të mjaftueshëm për t'u mundësuar diskutimi. Shembull: në qoftëse në komunë ka vetëm dy ose tri bashkësi dhe secila nga ato nga një përfaqësues në komision atëherë mundësitë për diskutim janë të kufizuara në dialog të dy apo tre vetave. Në raste të këtilla do të ishte mirë që secila bashkësi të jetë e përfaqësuar me nga dy ose tre përfaqësues dhe ashtu të vendoset ndonjë forum për diskutim. Në tjetër rast, në qoftë se në komunë janë të përfshira 6-7 bashkësi nominimi i më shumë se dy përfaqësuesve nga secila do të sjellë deri te formimi i komisionit të madh dhe do të jetë shumë vështirë për punë dhe diskutime.

Statuti i komunës duhet të përcaktojë numër optimal të anëtarëve të KMNB për t'u mundësuar debat i hapur dhe i sinqertë, duke mundësuar që çdo bashkësi të nominojë përfaqësues me qëndrime të ndryshme.

3) RREGULLORJA

Rregullorja është, po ashtu, një dokument formal që është relevant për plotësimin e të gjitha çështjeve të domosdoshme për punën e KMNB, pa u stërngarkuar përmbajtja e Statutit të komunës. Për dallim nga Statuti, Rregullorja nuk paraqet

obligim ligjor, por më shumë është akt për *përdorim të brendshëm* të KMNB dhe prandaj duhet të përpunohet dhe miratohet nga vetë KMNB.

Roli primar i Rregullores është që t'i rregullojë dhe t'i përshkruajë aspektet teknike të organizatës dhe punës, zakonisht të organeve të cilat punojnë në krijimin e politikave të caktuara dhe miratimin e akteve, vendimeve dhe zgjidhjeve. Dobi kryesore për ekzistimin e këtij dokumenti është se ai të gjithëve do t'ua sqaronte në mënyrë të plotë dhe të barabartë rregullat themelore për punën e KMNB dhe do të jepte përshtypje të një organi të organizuar mirë dhe në mënyrë transparente, do të mundësonte debate më efikase dhe më efektive dhe do të ndihmonte të mënjanohen trajtimet e gabuara rreth çështjeve të cilat i shqyrton KMNB.

Në rastin konkret Rregullorja do të përmbante dispozita për detalet rreth përbërjes, organizimit dhe punës (thirrja e seancave, koha e mbledhjes, afatet, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve në suaza të KMNB, mbështetja administrativo-teknike dhe organe të tjera relevante). KMNB mundet të kërkojë ndihmë teknike gjatë përpunimit të rregulloreve të tyre¹.

4) MBËSHTETJA NGA ANA E KOMUNËS

Që të mundet KMNB të funksionojë në mënyrë përkatëse duhet të sigurohen kushte të caktuara. Që të mundësojë punën e komisionit, komuna do të duhej të sigurojë kushtet në vijim:

- **Hapësira për punë** – hapësirën për mbajtjen e seancave të komisionit, materiale punuese – qasje deri te ligjet e nevojshme, qasje në internet, hapësirë për materiale përgatitore të anëtarëve të komisionit.
- **Mbështetja administrative** - të sigurojë persona përgjegjës nga ana e administratës komunale e cila do t'i

kryejë punët administrative në Komision, si për shembull dërgimin e ftesave dhe korrespondencës tjetër, marrjen e shënimeve na mbledhjet, sigurimin e dokumenteve të nevojshme dhe të tjera materiale.

- **Buxheti për punën e Komisionit** –puna e Komisioneve bart edhe shpenzime të caktuara lidhur me:
 - *Shpenzimet ditore* të anëtarëve të KMNB. Anëtarët nuk kanë të drejtë rroge, por ekziston mundësi për mbulimin e shpenzimeve të tyre ditore (për transport dhe ushqim) për shkak të pjesëmarrjes në seanca1.
 - Buxhet për *aktivitetet e propozuara nga Komisioni* – komuna mundet të përfshijë në programin e saj vjetor për punë , aktivitete të propozuara nga ana e KMNB, në pajtim me buxhetin e planifikuar.

III MANDATI I KOMISIONIT

Kuptuar si organ konsultativ i Këshillit dhe si forum për mundësimin e të gjitha bashkësive të komunës që të munden ta shprehin mendimin e tyre për temat dhe çështjet e caktuara, mandati dhe roli i Komisionit do të mund të përmblihet për temat në vijim të cilat janë më poshtë të elaboruara:

- **Çështjet juridiko-obliguese** lidhur me Nenin 41 të BVL
- **Zgjidhja e konflikteve** dhe mosmarrëveshjeve
- **Promovimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet bashkësive**
 - Prezentimi i mendimeve dhe rekomandimeve deri te këshilli1
 - Informimi dhe sqarimi i çështjeve të qytetarëve (bashkësive)

1) Çështjet juridiko-obliguese

Raste të cilat janë temë e diskutimit nga ana e KMNB, në pajtueshmëri me Ligjin për vetëqeverisje lokale

Neni 41

(Puna e seancave të Këshillit)

(3) Rregullat që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës dhe alfabetit që e përdorin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, verifikimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës, miratohen me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit, ku duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të këshillit të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë popullatë shumicë në komunë.

Roli i KMNB është që të shprehen mendime të bashkësive të ndryshme dhe në mënyrë plotësuese, të informohen edhe vetë bashkësitë, posaçërisht t'u shpjegohen situatat të cilat nuk kanë konotacion etnik, por ndoshta kanë qenë të interpretuara si të tilla. Duke marrë parasysh gjendjen dhe rrethën socio-ekonomik, komunat nuk janë çdoherë në gjendje t'i zgjidhin problemet në mënyrën dhe dinamikën me të cilën do të dëshironin. Ndonjëherë hasin edhe në mosmarrëveshje, dezinformata, spekulime dhe thashetheme të cilat çojnë deri te interpretime të gabuara për aktivitetet e ndryshme të ndërmarra.

Komunikimi dhe puna transparente e njësive të vetëqeverisjes lokale janë një nga synimet për ndërtim të mirëbesimit dhe respektit.

Në rastet kur miratohen vendime rreth çështjeve të cilat janë me interes të veçantë për bashkësitë, Këshilli Komunal është i obliguar të shfrytëzojë parimin e shumicës së dyfishtë (të ashtuquajturin “Badinter”). Ligji për vetëqeverisje lokale i përmend çështjet në vijim:

1. kultura
2. përdorimi i gjuhës
3. emrat e rrugëve dhe objekteve tjera infrastrukturore
4. përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës.

Shumica e dyfishtë, gjegjësisht e ashtuquajtura “**Shumica e Badinterit**” përcakton se disa vendime të këshillit komunal duhet të votohen me shumicë nga anëtarët e pranishëm të Këshillit, ku duhet të ketë edhe shumicë nga votat e anëtarëve të pranishëm në Këshill të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në komunë.

Ky rregull është vendosur në Ligj me qëllim që të stimulohet dialogu mes bashkësive dhe të sigurohet se për disa çështje të caktuara do të merret mendim dhe pëlqim.

1. Në pjesën e kulturës ky parim implementohet në rastet si vijon:
 - Mbështetje institucionale dhe financiare e institucioneve dhe projekteve kulturore
 - Promovimi i folklorit, traditave, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore
 - Organizimi i manifestimeve kulturore
 - Mbështetje formave të ndryshme krijuese
2. Lidhur me përdorimin e gjuhëve, Ligji i vetëqeverisjes lokale jep rregulla të qarta:

- Në komunat, gjuha zyrtare, përsëri gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, është edhe gjuha dhe alfabeti të cilën e përdorin më së paku 20% e qytetarëve të komunës1.
- Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetit që përdoren nga më pak se 20% e qytetarëve të komunës, vendimin e sjell këshilli komunal.

55% e popullatës jeton në komuna ku së paku një bashkësi është prezente me më shumë se 20%1.

3. Emrat e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore përcaktohen me vendim të këshillit komunal, me përdorimin e “ Shumicës së Badinterit” dhe rregullave në vijim:
 - Emri i objektit infrastrukturor mundet të përcaktohet me kuptim gjeografik, etnografik, historik ose tjetër, emri i personalitetit historik, shkencor dhe kulturor, emra të tjerë të përshtatshëm, si edhe ngjarje dhe data të rëndësishme, mbi bazë të listës së emrave të përcaktuara nga Këshilli Komunal nga miratimi paraprak i Qeverisë.

Nuk është e lejuar që objektet infrastrukturore të emërohen me emra që e fyejnë dinjitetin e shtetit, t'i fyejnë ndjenjat kombëtare të qytetarëve maqedonas dhe qytetarëve të shteteve tjera, *si edhe nëse i acarojnë marrëdhëniet mes bashkësive, traditat dhe moralin publik1.*

4. Përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës janë të rregulluara me Ligjin për përdorimin e flamujve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, sipas të cilit :

- Këshilli Komunal miraton vendime për përcaktimin e organit kompetent për përdorimin e flamurit të bashkësive në komunat ku shumica e qytetarëve (mbi 50%) i takojnë bashkësisë së caktuar.

Ka disa raste nëpër komunat, ku vendimi për stemën dhe flamurin e komunës është miratuar nga ana e këshillit komunal pa konsultimin paraprak të KMNB. Arsyetimi zakonisht është se çështja ka qenë e zgjidhur në “ **nivel më të lartë politik**” dhe mendimi i KMNB nuk është marrë si relevant.

Çështjet e lartpërmendura llogariten si relevante për marrëdhëniet mes bashkësive, që do të thotë se çdoherë kur Këshilli miraton akt lidhur me këto çështje, është i obliguar të marrë parasysh mendimin e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive. Prandaj rekomandohet që KMNB dhe Këshilli Komunal të vendosin komunikim më të rregullt, që të sigurohet që KMNB të jetë në mënyrë të rregullt i informuar për pikat relevante nga rendi i ditës i Këshillit. Në këtë mënyrë, Komisioni do të kishte mjaft hapësirë të takohet dhe t'i diskutojë çështjet dhe të konsultohet me ekspertë për ndonjë çështje konkrete. KMNB është, po ashtu, e autorizuar të kërkojë edhe ndihmë nga administrata komunale gjatë elaborimit të çështjeve të caktuara. Si hap i fundit procedural në këto raste, KMNB e jep mendimin/propozimin e vet deri te këshilli para se ai të marrë vendim për çështje të caktuara.

2) Zgjidh konfliktet dhe mosmarrëveshjet – rastet të cilat do të mund të shqyrtohen nga komisioni

Ka raste të cilat në mënyrë indirekte mund të krijojnë jotolerancë dhe mosbesim etnik, ose të gjenerojnë humbjen e besimit. Në përditshmërinë (si rezultat i ndikimit politik), ka ngjarje dhe raste të cilat njerëzit i interpretojnë si etnikisht të motivuara ose si konflikt ndëretnik. Analizat e mëtutjeshme të këtyre rasteve tregojnë se ato nuk kanë qenë etnikisht të motivuara dhe se zgjidhja mund të gjendet me diskutim të thjeshtë konstruktiv. Në periudhën e kaluar si më karakteristike u regjistruan raste si vijon:

- a) Kontestet rreth kullotjes së kafshëve;
 - b) Prishjet/vandalizmi mbi varrezat dhe shenjat rrugore;
 - c) Mosmarrëveshjet ndërmjet nxënësve në shkolla dhe fëmijëve në rrugë;
 - d) Dëmtimi i autobusëve (hedhja e gurëve mbi autobusë, trena);
- a) Kontestet rreth kullotjes së kafshëve

Në fshatra, fëmijët janë ata të cilët kujdesen për kafshët. Ndonjëherë ka raste kur kopeja, nga pakujdesia, kullot në vende të gabuara, për shembull, në ara të huaja në vend të kullosave publike. Këto janë mosmarrëveshje të përditshme në rajonet rurale dhe vende ku popullsia merret me bagëti. Rastet e këtilla kanë ekzistuar gjithmonë – problemi shfaqet kur prezentohen në kontekst të marrëdhënieve ndëretnike.

Në komunat etnikisht të përziera janë shënuar raste ku kopetë hynë në varrezat e fshatrave fqinje. Për fat të keq, nëse bariu i takon grupit tjetër etnik rasti prezentohet si i qëllimshëm për të shkaktuar incident ndëretnik.

Pa dëshirë që të futemi në analiza të mëtutjeshme të rasteve të këtilla dhe motiveve të tyre, dëshirojmë të diskutojmë për

zgjdhjet e mundshme1. Rastet e këtilla banale të pakujdesisë njerëzore (ndonjëherë edhe fizikisht është e pamundur të kontrollohet kopeja) lehtë mund gabimisht të interpretohet dhe si rezultat i kësaj të rriten tensionet ndëretnike. Me qëllim që të pengohen rastet e këtilla, KMNB komunale ose Grupet këshilldhënëse të qytetarëve1 duhet t'i diskutojnë këto raste, t'i shprehin mendimet e tyre dhe të propozojnë zgjidhjet e mundshme dhe masat preventive deri te Këshilli Komunal.

- b) Prishjet/vandalizmi mbi varrezat dhe shenjat rrugore

Në vitet e kaluara mediumet informojnë për disa raste të shkatërrimit të shenjave të pllakave të varrezave dhe të përkujtimeve. Kryerësit rrallë herë janë gjetur. Disa raste ishin rezultat i lojës joadekuate të fëmijëve ose kryerësve nën ndikim droge ose alkooli. Sërish, këto raste e zmadhojnë tensionin mes popullatës. Për rastet të cilat nuk kanë sqarime valide ose informata, “çarshia” prodhon interpretimet dhe tregimet e veta. Ndonjëherë, këto “interpretime” përfshijnë akuza dhe deklarime kundër një grupi tjetër etnik.

E zakonshme është që opinionin të krijojë thashetheme në rastet kur nuk ka mjaft fakte ose ato janë më në numër të vogël. Prandaj do të jetë e dobishme që Këshilli Komunal të kërkojë nga KMNB t'i shqyrtojë këto raste dhe të japë mendim. Ky mendim nuk e ndryshon investigimin zyrtar të policisë por është mirë që përfaqësuesit nga të gjitha bashkësitë etnike me deklaratë të përbashkët të dënojnë kryerësit dhe sjelljet vandale.

Në rastet ku kryerësit janë të njohur dhe/ose grupet e ndryshme janë të involvuara, KMNB mundet të organizojë takime të përbashkëta me përfaqësuesit nga ato bashkësi të debatojnë dhe pengojnë tensionet e mëtutjeshme ose rastet e ngjajshme.

- c) Mosmarrëveshjet ndërmjet nxënësve në shkolla dhe fëmijëve në rrugë

Natyra e njeriut është e prirur për krijimin e konfrontimeve dhe rivalitetit, dhe këto tendenca janë mjaft të pranishme në fëmijëri. Rivalitetet paraqiten gjatë tërë jetës – mes qyteteve fqinje ose skuadrave të tifozëve, rivaliteti është i theksuar edhe mes nxënësve nga shkollat e ndryshme deri edhe mes klasave të së njëjtës shkollë. Këto rivalitete natyrore ndonjëherë mund të eskalojnë në ballafaqime verbale ose fizike mes individëve ose grupeve. Shumica nga nxënësit në një moment të caktuar marrin pjesë në ndonjë rivalitet.

Rastet e paradokshme të fjalosjeve mes nxënësve nga një shkollë e mesme rezultuan me masa të shtuara të sigurisë në shkollat. Në rastet ekstreme, prindërit kërkuan që nxënësit të mësojnë në shkolla të ndara, ose, nëse kjo nuk është e mundshme, mësimi të zhvillohet në turne të ndryshme.

Ky është një nga problemet ku KMNB mund të luajë rol aktiv duke punuar me gjithë të involvuarit dhe palët përgjegjëse dhe të kyçet në diskutimet me ta dhe me përfaqësuesit e shkollave (profesorët), prindërit dhe nxënësit. Zbulimi i motivit të vërtetë për konfrontimin do të çonte drejt ndalimit të suksesshëm të këtyre dukurive.

Edukimi i fëmijëve është përgjegjësi e gjithë bashkësisë – përgjegjësi e përbashkët e familjes dhe gjithë shoqërisë. Kultivimi i gjeneratave produktive dhe të shëndosha është në interes shoqëror, dhe është shumë e rëndësishme që të ndahet përgjegjësia dhe të bashkohen përpjekjet. Fëmijët i imitojnë të rriturit, por jo gjithnjë kanë aftësi në mënyrë të caktuar të komentojnë atë që e dëgjojnë apo e shohin. Sjellja e cila mësohet në fëmijëri cakton se si individët do të sillen kur të rriten, dhe prandaj është në interes të të gjithëve të gjejmë zgjidhje të vërteta dhe afatgjate.

Rasti i Sopishtes

Një grup nxënësish në stacionin e autobusëve e sulmuan një nxënës të një vendbanimi tjetër. Për shkak se nxënësi ishte rëndë i lënduar të gjithë prindërit e vendbanimit ishin të alarmuar. Në shenjë proteste dhe duke u frikësuar për sigurinë e fëmijëve të tyre qytetarët i ndalonin autobusët dhe nuk u lejonin të vazhdojnë udhëtimin deri te vendbanimi i sulmuesve. Tensionet u zmadhuan deri sa që për incidentin u akuzua e gjithë bashkësia nga vendbanimi fqinj.

Duke i pasur parasysh marrëdhëniet e ndjeshme ndëretnike të involvuarve në këtë incident, policia vuri në dukje se veprimet e tyre mund vetëm plotësisht t'i eskalojnë tensionet. U propozua që bashkësitë të diskutojnë për rastin dhe të tentojnë të arrijnë zgjidhje të përbashkët.

KMNB lokale arriti ta qetësojë situatën dhe propozoi disa masa dhe aktivitete për parandalimin e tensioneve të mëtejshme ose incidenteve të ngjajshme. Komisioni i përbërë nga përfaqësuesit e dy vendbanimeve propozoi që të organizohet një garë sportive me skuadra të përziëra nga të gjitha bashkësitë. Këto aktivitete plotësisht u përkrahën nga pushtetet komunale.

- d) Sulmet me gurë mbi autobusët e transportit publik (autobusë dhe trenat)

Në disa raste autobusët e transportit publik (dhe trenat) ishin të sulmuar me gurë, ndërsa janë vërejtur sulme edhe ndaj vozitësve. Si rezultat i këtyre incidenteve, ndërmarrja publike refuzoi të vazhdojë me transportin publik në ato vendbanime. Nga ana e qytetarëve kjo u interpretua si vendim me motive etnike.

Në raste të këtilla, të gjitha palët pësojnë humbje. Ndërmarrja transportuese shpenzon para për riparimin e automjeteve dhe në opinion ballafaqohet me imazh negativ, ndërsa qytetarët ballafaqohen me problemet e mospasjes qasje deri te transporti publik.

Një nga përgjigjet e mundshme është që të diskutohet dhe të tentohet që këto probleme të zgjidhen bashkarisht. Ndoshta qytetarët nuk janë të kënaqur me rregullsinë e transportit publik, ndërsa kompania ka këndvështrimin e vet për sulmet mbi transportin publik, pagesa e biletave etj.

3) Promovimi i marrëdhënieve të mira mes bashkësive – drejtime të mundshme për aktivitetet e KMNB

Siç theksuam më sipër, puna e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive është e rregulluar me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Komisionit. Me qëllim që të shtohet efikasiteti, rekomandohet që komisioni të përgatisë programin e vet vjetor të punës. Këtë program duhet ta miratojë edhe këshilli i Komunës dhe ta inkorporojë në programin për punë dhe buxhetin e komunës.

Aktivitetet e veta komisioni mund t'i drejtojë, siç vijon:

Në rast të konfliktit mes dy ose më shumë palëve, anëtarët e KMNB mund të takohen me çdo palë të involvuar, për të marrë qëndrim të njëjtë dhe të mësojë për rastin.

Nëse shfaqet nevoja, Komisioni mund të lëshojë lajmërim ose me deklaratë të vetën t'i informojë qytetarët për iniciativat ose pikëpamjet e tyre për çështje të caktuara.

Në bashkëpunim me këshillin komunal, komisioni mund të iniciojë disa aktivitete të cilat do të mundësojnë bashkëpunim dhe njohje mes bashkësive. Si për shembull:

- të organizojnë takime të ndryshme, aktivitete kulturore ose sportive;
- të shpallin mendimin e tyre për ngjarje të ndryshme të cilat do të mund të shkaktojnë tensione në marrëdhëniet mes bashkësive

Aktivitetet e KMNB në komunën e Sopishtes
KMNB në Sopishte ishte shumë aktive me dorëzimin e numrit të madh të propozimeve deri te këshilli komunal në më shumë lëmi:

- inicoi formimin e ligës futbollistike të skuadrave të përziera etnike;
- propozoi që qendra e re sportive të vendoset në vend qendror njëlloj të larguar dhe të arritshëm për të gjitha vendbanimet e komunës;
- ndërmjetësonte në incidentet ndërmjet të rinjve;
- përfundimet dhe propozimet e çdo sesiioni të KMNB rregullisht prezentohen para Këshillit Komunal;

Takim me qëllim që të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet Haraçinës dhe Bërnjarcit

Me inicijativë të kryetarit të komunës së Gazi Babës, më 17 Janar u mbajt takim ndërmjet banorëve të Haraçinës dhe Bërnjarcit. Në takimin morën pjesë kryetari i komunës së Haraçinës, dy deputet të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, kryesuesit e bashkësive lokale, drejtuesit e stacioneve policore në Haraçinë dhe Autokomandë, përfaqësues të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Arsyeja për takimin ishte incidenti i cili, sipas dëshmitarëve, u shkaktua nga ana e vendbanimit të banuar me Shqiptarët etnik.

Të gjithë të pranishmit e dënuan incidentin dhe e vërtetuan gatishmërinë e tyre që ta intensifikojnë bashkëpunimin me qëllim që ta zgjidhin rastin. Po ashtu, u arit marrëveshja që Bërnjarcit dhe Haraçina të formojnë këshill të përbashkët për tejkalimin e problemit.

Në fund u arit marrëveshje që takimi i ardhshëm të organizohet në Haraçinë ku edhe zyrtarisht do të formohet këshilli.

Shtojcë

4) Lista e Komunave të cilat kanë obligim të formojnë KMNB

Sipas analizave të IZHB komunat në vijim kanë obligim ligjor të formojnë KMNB. Në secilën prej këtyre komunave numër i njëjtë i përfaqësuesve të secilës nga bashkësitë e përmendura duhet të marrin pjesë në komision. Komuna mundet, sipas njohurive të saj, të ftojë edhe përfaqësues të bashkësive tjera të cilat janë të përfshira në komunë në numër të konsiderueshëm.

Nr.r.	Komuna	Bashkësitë të cilat duhet të përfaqësohen në Komisionin
1.	Bërvenicë	maqedonas, shqiptarë, serbë,
2.	Vraneshticë	maqedonas, shqiptarë, serbë, turq
3.	Gostivar	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, ser,
4.	Dibër	maqedonas, shqiptarë, turq, romë,
5.	Dollnen	maqedonas, shqiptarë, turq, boshnjakë,
6.	Zelenikovë	maqedonas, shqiptarë, romë, serbë, boshnjakë,
7.	Jegunovc	maqedonas, shqiptarë, serbë, romë
8.	Kërçovë	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë
9.	Krushevë	maqedonas, shqiptarë, turq, vlllehë, boshnjakë,
10.	Kumanovë	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë
11.	Mavrovë dhe Rostushë	maqedonas, shqiptarë, turq
12.	Petrovec	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë,
13.	Sopishtë	maqedonas, shqiptarë, turq

14.	Strugë	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë
15.	Tetovë	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë
16.	Çashkë	maqedonas, shqiptarë, turq, serbë, boshnjakë
17.	Çuçer Sandevë	maqedonas, shqiptarë, serbë
18.	Shkup	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë, boshnjakë
19.	Butel	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë, boshnjakë
20.	Çair	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë, boshnjakë
21.	Shutë Orizar	maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë

Shtojca II

5) Propozim për përmbajtjen e Rregullores për punë të KMNB

Kur çështjet lidhur me KMNB do të rregullohen me Statutin e komunës dhe KMNB do të formohet, disa çështje praktike lidhur me funksionimin e KMNB duhet të rregullohen me Rregulloren e punës. Me rëndësi është që të rregullohen çështjet në vijim:

- Cila gjuhë të përdoret në seancat e KMNB dhe çështja eventuale për përkthim (rekomandohet që të përdoret *një nga gjuhët të cilën të gjithë e kuptojnë*, ndërsa për ata të cilët nuk janë në gjendje ta përdorin, të sigurohet përkthim nga ana e administratës komunale);
- Detale për përbërjen e KMNB: kush mundet të thirrë seancën konstituive, procedimin/mënyrën e konstituimit, kuorumin e nevojshëm për konstituim;
- Procedimi për zgjedhjen e kryetarit të KMNB;

- Autorizimet dhe obligimet e anëtarëve të KMNB – kryetari duhet të jetë “i pari mes të barabartëve”, vetëm të drejtojë me seancën dhe, po ashtu, të ketë autorizim ta informojë opinionin për punën e KMNB. Pas listës standarde të të drejtave dhe obligimeve, në këtë kuptim posaçërisht duhet të jenë të theksuara edhe parimet e tolerancës, mirëkuptimit, dialogut, argumentimit;
- Për çfarë shkak duhet të takohet KMNB, sa shpesh dhe ku;
- Seancat e KMNB – kush thërret seancën, cilat janë afatet dhe procedurat për informimin e anëtarëve për seancë, si definohet dhe ndërrohet agjenda, si edhe kush e përgatit dokumentacionin i cili është relevant për seancën; cili është kuorumi për mbajtjen e seancës¹, kush e mban procesverbalin, si të njëjtat verifikohen; kush dhe si jep mbështetje administrative dhe teknike, si debatohet dhe vendoset për llojet e ndryshme të çështjeve, si i dorëzojnë dokumentet deri te Këshilli dhe të tjerët, etj.;
- Si KMNB do të identifikojë dhe zgjedhë çështje relevante. Duhet të bëhen në një nga mënyrat në vijim:
 - analizimi i agjendave të Këshillit Komunal;
 - me iniciativë të këshilltarëve komunalë ose komunikim me administratën komunale;
 - me iniciativë personale të anëtarëve të KMNB;
 - me shqyrtimin e propozimeve/iniciativave të dorëzuara nga qytetarët;
 - me shqyrtimin e propozimeve nga grupet joformale dhe formale të qytetarëve (partive politike, OJQ-ve, bashkësive lokale);

- me shqyrtimin e akteve dhe dispozitave të përgjithshme në komunë dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në implementimit e tyre te bashkësitë e ndryshme etnike dhe marrëdhëniet e tyre.
- Mënyra e verifikimit të çështjeve relevante;
- Lloji dhe formati i dokumenteve të lëshuara nga KMNB;
- Mënyra e dorëzimit të rezultateve nga puna e KMNB deri te Këshilli dhe të tjerët;
- Procedura për pranimin dhe ndryshimin e Rregullores së punës;
- Shfrytëzimet teknike dhe ndihmat e ekspertëve (nga administrata ose nga ekspertë të jashtëm);
- Bashkëpunimi i KMNB me palët tjera të interesuara, komunikimi me qytetarët, transparenca e punës;

IV Referencat/bibliografia

Web faqja e Bashkësisë të njësisë të vetëqeverisjes lokale (BNJVL) – www.zels.org.mk, paraqet mjet të dobishëm dhe me përmbatje të një numri të madh të informatave dhe risive lidhur me zhvillimin e vetëqeverisjes lokale. Në këtë internet faqe mundet të gjenden edhe informata lidhur me punën e KMNB si për shembull:

- modeli i statutit komunal
- rekomandime për nenin-model të statutit komunal për rregullimin e punës së KMNB.
- Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare 5/2002;
- Ligji për zbatimin e buxhetit të R.M. 2007;
- Ligji për kulturë, Gazeta zyrtare 59/2003;
- Ligji për bibliotekat, Gazeta zyrtare 66/2004;
- Ligji për përmendoret, Gazeta zyrtare 66/2004;
- Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, Gazeta zyrtare 20/2004;
- Ligji për përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore, Gazeta zyrtare 66/2004.

